



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.432/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Fejzullah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Arjeta Mahalla, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** si të pa rregullta ankesat e Arjeta Mahalla, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me shenjen ZL.Anr.432/2017 dhe ZL.A.nr.434/2017 tw datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

### A r s y e t i m

Më datën 23.10.2017, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa nga Arjeta Mahalla, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Ferizajt, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilat kërkon që të rinumërohen votat në Talinoc të Muhaxherëve, në vendvotimet: 2513D/01R, 2513D/02R, 2013D/03R, dhe në shkollën “Pjetër Bogdani”, në vendvotimet: 2501x/01R, 2502x/02R, 2502x/03R, 2502x/04R, 2502x/05R, 2502x/06R, 2502x/07R, 2502x/08R, 2502x/09R, 2502x/10R, 2502x/11D, për shkak të mos vendosjes së votave të familjarëve në këto vendvotime.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.432/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesat janë të pa rregullta**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana e Arjeta Mahalla, janë të parregullta sepse nuk janë nënshkruar nga Arjeta Mahalla dhe si të tilla ankesa nuk i plotëson kushtet siç kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015, të PZAP-it dhe në

bazë të nenit 118 të LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtetj të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.432/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Zyheri Haziri



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*